

Këshilli drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i Komitetit dhe përbëhet nga kryetari, si dhe nga një përfaqësues të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil i Ministrisë së Drejtësisë, i ministrisë që mbulon fushën e shëndetësisë, i ministrisë që mbulon fushën e arsimit dhe shkencës, i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i ministrisë që mbulon fushën e rendit publik, i ministrisë që mbulon fushën e financave, i ministrisë që mbulon fushën e çështjeve sociale, një pedagog i së drejtës familjare nga universitetet publike dhe një përfaqësues i shoqatës së jetimëve.

Detyrat e këshillit drejtues të Komitetit

- 1. Vendos për përshtatshmërinë e aplikantëve birësues.*
- 2. Jep pëlqimin, me shkrim dhe në mënyrë kolegjiale, për birësimin e fëmijës nga aplikantët birësues, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.*
- 3. Merr masat e nevojshme për të shmangur dështimin e birësimeve, përfitimet e padrejta, si dhe çdo lloj veprimtarie, që synon trafikimin e fëmijëve.*
- 4. Cakton kohëzgjatjen, mënyrën dhe vendin ku do të realizohet periudha e provës për përshtatshmërinë e birësuesve me të birësuarin.*
- 5. Miraton projektbuxhetin e Komitetit dhe propozon strukturën organike të tij.*
- 6. Miraton programet e punës së Komitetit dhe politikat përkatëse për përmirësimin e procedurave të birësimit.*
- 7. Analizon, në fund të çdo viti, veprimtarinë financiare dhe administrative të Komitetit.*
- 8. Propozon për miratim, me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave, tarifat për shërbimet e kryera për birësim.*
- 9. Përbush detyrimet që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara për të drejtat e fëmijëve në birësim.*
- 10. Bën propozime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e birësimit, në interes të fëmijës.*
- 11. Vlerëson për çdo rast përfundimet për bashkimin birësues - i birësuar, që ka miratuar dhe mbikëqyr nëse birësimi i përgjigjet interesit më të lartë të fëmijës.*
- 12. Shfuqizuar.*
- 13. U kërkon agjencive, vendase dhe të huaja, informacion për gjendjen e fëmijës së birësuar, në afate të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar me to.*
- 14. Nxiti bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve qendrore të vendeve të tjera, si dhe hartimin e marrëveshjeve dypalëshe me agjencitë e huaja ndërmjetëse.*
- 15. Miraton veprimtarinë e agjencive të huaja, që punojnë në fushën e birësimit në Shqipëri.*
- 16. Informohet për veprimtarinë e agjencive të licencuara, pas kontrolleve të ushtruara nga strukturat e Komitetit dhe, kur vëren se ato kanë kryer shkelje të detyrimeve ligjore, propozon masa administrative deri në heqjen e licencës.*